



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E DISA QENDRAVE TË VOTIMIT NË NDËRTESA PRIVATE, PËR ZGJEDHJET
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 26.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA-	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	Bitri-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Caktimin e disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 93, pika 2, gërma "a", e Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Kryetari i Bashkisë, në zbatim të neneve 62, pika 4, dhe 93, pika 2 dhe 3, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, në rast të pamundësisë të caktimit të vendndodhjes së QV-së në ndërtesë publike, brenda territorit të qendrës së votimit, apo në zonë votimi fqinje, ka detyrimin t'i propozojë KQZ-së propozimin për caktimin e QV në ndërtesë private.

Kryetari i Bashkisë Kamëz me shkresën nr.4130 datë 22.05.2019 ka paraqitur propozimet për caktimin e vendndodhjes së 44 QV në ndërtesa private.



Për sa referohet në propozimin e Kryetarit të Bashkisë, mungesa e ndërtetasve publike është shkak për propozimin e caktimit të vendodhjes së QV në ambiente private.

Nga 44 QV të propozuara në ndërtesa private:

- 34 QV propozohen në të njëjtën vendndodhje sikundër në zgjedhjet 2017;
- 10 QV propozohen në vendodhje të ndryshme nga zgjedhjet 2017.

Pas verifikimit në terren të ndërtesave private të propozuara për caktimin e vendndodhjeve të 44 QV, rezultoi se për 27 QV ka mundësi objektive për të caktuar vendndodhjet në ndërtesa publike, shkolla, në zonat e qendrave të votimit fqinjë.

Kryetari i Bashkisë Librazhd, me shkresën nr. 4143, datë 22.05.2019, paraqet propozimin për ndryshimin e vendodhjes së QV nr. 2761/1, nga shkolla "Rahman Çota" (Hotolisht Qendër) në ndërtesën private të z. Astrit Alliu (fshati Çerçan). Arsyeja për të cilën kërkohet ndryshimi është distanca mbi 5 km nga fshati Çerçan në Njësinë Administrative Hotolisht.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 93, pika 2, gërma "a", pika 3, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I

1. Caktimin e qendrave të votimit në ndërtesa private dhe publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes Nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore të kryejë menjëherë lajmërimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjen e qendrës së votimit, të caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

